

# Akt Themelimi

i shoqërisë tregtare “Max Food Delivery” sh.p.k

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë , në ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqëritë tregatë” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi në një ortak të vetëm :

**IONUT-LAURENTIU DOBRII** lindur më datë 11.06.1986, në Campina dhe banues në Rumani.

Të krijojë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “MAX FOOD DELIVERY” sh.p.k me akt themelimi si vijon:

## **Neni 1 - Formulimi**

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “MAX FOOD DELIVERY” sh.p.k . Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të kete selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët.

## **Neni 2 - Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë tregtare private “MAX FOOD DELIVERY” sh.p.k do të ketë selinë në adresën Rruga Teodor Keko, Pallati Ales, Kati 2, Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë.

## **Neni 3 - Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e përcaktuar si më poshtë:

- Aktivitet i shpërndarjes së ushqimeve - delivery

#### **Neni 4 - Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jete me një afat të papërcaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

#### **Neni 5 - Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali fillestar i shoqërisë private "MAX FOOD DELIVERY" sh.p.k do të jetë 10.000 (dhjetë mijë euro). Kapitali është i ndarë në 1 kuotë. Kapitali themeltar fillestar mund të ndryshohet (por jo të pakësohet nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

#### **Neni 6 - Drejtimi i Shoqërisë**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Reison Gjaçi. Cdo nënshkrim do të kryhet prej tij dhe në rast mungese, do të kryhet nga një përfaqësues i pajisur me prokurë nga administratori.

#### **Neni 7- Të ardhurat**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm.

#### **Neni 8**

Ortaku ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë, të caktojë financiarë, likuidatorë për problemet e shoqërisë si dhe të përcaktojë persona të tjerë si ortakë.

#### **Neni 9**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **Neni 10**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare, të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

#### **Neni 12**

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "MAX FOOD DELIVERY" sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm themelues.

**Ortaku i vetëm themelues i "MAX FOOD DELIVERY" sh.p.k**

**IONUT-LAURENTIU DOBRII**



Dobrii Ionut

Laurentiu